

SHOQERIA :TURGUT OZAL EDUCATION SH.A.

Datë, 17 / 10 / 2019

NIPTI : K 12 12 50 04 O

DEKLARATE

Deklaroj se **Shoqëria jone** "Turgut Ozal Education" Sh.a. me **NIPT K12125004O** me Administrator te Pergjithshem **Z. MUSTAFA ÜSTÜNER** dhe aksioner te vetem ne daten 31.12.2018 :

- BF Cooperatief UA, perqindja e pjesemarrjes 100 %, me 1,133,700 aksione me vlere 1.000 leke/aksion.

ka hartuar pasqyrat financiare të vitit 2018 komform ligjeve ne fuqi per kontabilitetin.

Hartuesi i pasqyrave financiare eshte:

Znj. Gezime Onat, ekonomiste e punësuar pranë shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë

MUSTAFA ÜSTÜNER



TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe për
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO	7
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	8
SHËNIME SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE	9 – 36

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtuesve të Shoqërisë Turgut Özal Education Sha,

Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Turgut Özal Education Sha ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018 dhe pasqyrën e fitim ose humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare më dhe për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të përshkruara në paragrafin Baza për Opinionin me Rezervë e këtij raporti, pasqyrat financiare të bashkëlidhura pasqyrojnë në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018, performancën financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur më këtë datë sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për Opinion me Rezervë

Aktivitet afatgjata materiale

Sikurse pasqyrohet në shënimin shpjegues nr. 4 të pasqyrave financiare, aktivitet afatgjata materiale janë të raportuara me një vlerë prej 2,197,897,322 Lek më 31 dhjetor 2018 (2017: 2,202,450,067 Lek). Shoqëria nuk disponon një regjistër të përshtatshëm të aktiveve afatgjata materiale siç kërkohet nga Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit nr.16 "Aktivet afatgjata materiale" dhe nuk ka kryer një inspektim fizik për të konfirmuar ekzistencën, kushtet fizike të aktiveve dhe plotësinë e vlerës së raportuar më 31 dhjetor 2018. Në mungesë të tyre, nuk ishim në gjendje të plotësonim kërkesat tona nëpërmjet procedurave alternative për ekzistencën, plotësinë, saktësinë dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimit të zhvlerësimit të lidhur me to, të raportuara në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018 dhe 2017. Meqëse teprica mbyllëse e aktiveve afatgjata materiale dhe e shpenzimit të zhvlerësimit ndikon në përcaktimin e performancës financiare dhe flukseve monetare të Shoqërisë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim, nëse, veprimet rregulluese mund të kenë qenë të nevojshme lidhur me aktivitet afatgjata materiale të pasqyrur në pasqyrën e pozicionit financiar, fitimin për vitin raportues e pasqyruar në pasqyrën e fitim ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe flukset monetare neto nga aktivitetet investuese dhe operative të pasqyruara në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018.

Baza për Opinion me rezervë (vazhdim)

Të ardhurat nga shërbimet

Sikurse pasqyrohet në shënimin shpjegues nr. 17 të pasqyrave financiare të ardhurat nga shërbimet janë të raportuara me një vlerë prej 1,187,204,418 Lek për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 (2017: 1,492,931,114 Lek). Shoqëria ka njohur të ardhurat nga shitja e shërbimeve për vitin akademik 2017-2018 mbi bazën e flukseve monetare hyrëse sipas kësteve të përcaktuara në kontratën me klientët dhe për vitin akademik 2018-2019 ka njohur të ardhurat nga shitja e shërbimeve mbi bazën e transferimit të kontrollit të shërbimit tek klientët. Si rrjedhojë, të ardhurat nga shërbimet nuk njihen, maten dhe pasqyrohen sipas SNFR 15 “Të ardhurat nga kontratat me klientët”, i cili kërkon që të ardhurat të njihen kur plotësohet (ose në masën që plotësohet) kushti i performancës duke transferuar shërbimin e premtuar (shkollimin) tek klienti. Për arsye të mungesës së evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit lidhur me stadin e dhënies së shërbimit, nuk është e mundur të kuantifikojmë ndikimin e kësaj çështjeje në pasqyrat financiare bashkëlidhur. Meqënëse të ardhurat ndikojnë në rezultatin e vitit, llogaritë e arkëtueshme tregtare, të ardhurat e shtyra dhe flukset neto të mjeteve monetare nga aktivitetet operative, nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse veprimet rregulluese kanë qënë të nevojshme lidhur me humbjen e vitit, llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të ardhurat e shtyra të pasqyruara respektivisht në pasqyrën e fitim humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 dhe në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar “Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare” të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (“BKSNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbledhjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhe shënimet shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.



Deloitte Audit Albania Shpk

Rruga Faik Konica, Ndërtesa nr. 6 Hyrja nr. 7, 1010

Tiranë, Shqipëri

Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41709002H

Audituesi ligjor
Partner Angazhim
Enida Cara

Tiranë, Shqipëri
17 tetor 2019

TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë të shprehura në LEK)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Aktivitet			
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	4	2,197,897,322	2,202,450,067
Aktive afatgjata jo material	5	530,605	368,029
Totali i Aktiveve afatgjata		2,198,427,927	2,202,818,096
Aktive afatshkurtra			
Inventari	6	17,702,948	19,021,513
Llogari të arkëtueshme tregtare	7	96,730,668	45,943,389
Aktive të tjera	8	75,844,584	68,151,973
Huatë	9	30,989,747	32,341,942
Tatim fitimi i parapaguar	27	32,875,174	-
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	10	15,491,401	31,913,820
Totali i aktiveve afatshkurtra		269,634,522	197,372,637
Totali i aktiveve		2,468,062,449	2,400,190,733
Detyrimet dhe kapitali			
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali aksionar	11	1,133,700,000	1,133,700,000
Rezerva të tjera	11	68,866,191	59,031,349
Fitime të pashpërndara	11	(102,108,822)	196,681,841
Totali i kapitalit		1,100,457,369	1,389,413,190
Detyrime afatgjata			
Huatë	12	499,211,091	639,768,873
Totali i detyrimeve afatgjata		499,211,091	639,768,873
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	13	49,591,397	40,316,745
Huatë	12	243,232,333	223,603,106
Detyrime të tjera	14	31,171,928	35,385,902
Detyrime ndaj palëve të lidhura	15	114,687,833	3,336,313
Të ardhura të shtyra	16	429,710,498	54,339,219
Tatim fitim i pagueshëm		-	14,027,385
Totali i detyrimeve afatgjata		868,393,989	371,008,670
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		2,468,062,449	2,400,190,733

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 9 deri më 36, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumatat janë të shprehura në LEK)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura			
Të ardhurat nga shërbimet	17	1,187,204,418	1,492,931,114
Të ardhura të tjera	18	201,929,727	204,332,900
Totali i të ardhurave		1,389,134,145	1,697,264,014
Shpenzime			
Shpenzime për personelin	19	(696,891,344)	(639,645,630)
Lendë e parë dhe mallra konsumi	20	(305,537,245)	(290,481,746)
Shpenzime karburanti dhe transporti	21	(102,307,479)	(98,382,641)
Shpenzime nga qiraja	22	(78,890,284)	(88,924,436)
Shpenzime shitjeje dhe marketing	23	(7,716,535)	(7,241,476)
Shpenzime sigurie		(24,373,934)	(22,523,440)
Zhvlerësim dhe amortizim	4,5	(127,506,060)	(144,724,458)
Kosto financiare	24	(41,236,660)	(44,920,015)
Fitim nga përkthimi i monedhave të huaja	25	46,121,466	11,592,155
Shpenzime të tjera operative	26	(152,904,892)	(139,220,747)
Totali i shpenzimeve		(1,491,242,967)	(1,464,472,434)
(Humbja)/fitimi para tatimit		(102,108,822)	232,791,580
Shpenzimi i tatim fitimit	27	-	36,109,739
(HUMBJA)/FITIMI PËR VITIN		(102,108,822)	196,681,841
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
TOTALI I (HUMJES)/ TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN			
		(102,108,822)	196,681,841

Pasqyra e fitim dhe humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 9 deri më 36, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA**Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë të shprehura në LEK)*



	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera	Fitimi i pashpërndare	Totali
Teprica më 31 dhjetor 2017	1,133,700,000	59,031,349	196,681,841	1,389,413,190
Humbja e vitit	-	-	(102,108,822)	(102,108,822)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i humjes gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	(102,108,822)	(102,108,822)
Transferimi i fitimit të pashpërndarë në rezerva të tjera	-	9,834,842	(9,834,842)	-
Shpërndarja e dividendit	-	-	(186,846,999)	(186,846,999)
Teprica më 31 dhjetor 2018	1,133,700,000	68,866,191	(102,108,822)	1,100,457,369

Pasqyrat Financiare janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në 27 Shtator 2019 dhe janë firmosur nga:

Gëzime Onat

Shefe kontabiliteti

Gëzime Onat


Mustafa Üstüner
 Mustafa Üstüner
 Drejtor ekzekutiv



Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 9 deri më 36, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumat janë të shprehura në LEK)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i shfrytëzimit		
(Humbja)/fitimi para tatimit	(102,108,822)	232,791,580
Rregullime për:		
Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi	127,506,060	144,724,458
Shpenzime interesi	38,616,418	43,851,153
Humbja nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	4,218,792
Ndryshim në provigjon për inventarin	13,805,292	400,266
Ndryshim në provigjon për çështje gjyqësore	1,611,617	2,701,706
Fitim nga përkthimi i monedhave të huaja	(47,471,055)	(11,358,540)
Fitimi nga aktiviteti i shfrytëzimit përpara ndryshimeve në kapitalin punues:	31,959,510	417,329,415
Rritje në llogaritë e arkëtueshme tregtare	(51,732,826)	(44,575,224)
Rritje në inventar	(12,486,727)	(6,016,750)
Rritje në aktive të tjera	(8,888,882)	(1,024,378)
Rënie/(rritje) në huatë	976,695	(32,341,942)
Rritje/(rënie) në llogaritë e pagueshme tregtare	9,418,134	(36,395,068)
Rënie në detyrime të tjera	(5,825,591)	(21,290,968)
Rritje në të ardhura të shtyra	375,371,279	54,339,219
Interesi i paguar	(38,927,535)	(41,842,098)
Tatim fitimi i paguar	(46,902,559)	(5,611,381)
Mjetet monetare neto gjeneruar nga aktiviteti i shfrytëzimit	252,961,498	282,570,825
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti investues		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(122,810,391)	(75,920,981)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale	-	766,833
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	(305,500)	(406,940)
Mjetet monetare neto përdorur në aktivitetin investues	(123,115,891)	(75,561,088)
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti financues		
Disbursime nga huatë	534,669,730	232,733,032
Shlyerje të huave	(592,272,861)	(298,742,380)
Dividend të paguar	(75,495,480)	(128,309,718)
Mjetet monetare neto përdorur në aktivitetin financues	(133,098,611)	(194,319,066)
(Rënie)/rritje neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre	(3,253,004)	12,690,671
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	31,913,820	23,121,426
Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit në mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	(13,169,415)	(3,898,277)
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	15,491,401	31,913,820

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 9 deri më 36, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Turgut Özal Education Sha (në vijim referuar si "Shoqëria") është një Shoqëri arsimore e themeluar fillimisht më 21 maj 2001 dhe regjistruar në autoritetet tatimore më 25 shtator 2001 me numër indentifikimi K121250040 si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "UFUK, Education & Publication Company", e cila është ndryshuar më vonë në "Turgut Ozal Education". Më 13 tetor 2011 Shoqëria ndryshoi formën e saj ligjore në shoqëri aksionare. Adresa e Shoqërisë është Rr. "Pavaresia", Aut. Tirane - Durres Km.1 / Tiranë. Për të siguruar arsimdhënie në të gjitha nivelet, në vitin 2007 hapet Universitetit "Epoka".

Shoqëria është bijë 100% e kontrolluar nga BF Cooperatief U.A. e cila është shoqëria përfundimtare kontrolluese. Kapitali i Shoqërisë është 1,133,700,000 Lek i përbërë nga 1,133,700 aksione me një vlerë nominale prej 1.000 Lek (një mijë lekë) secili. Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë është Z. Mustafa Üstüner.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është të përmbushë standardet dhe të ndjekë programet e miratuara nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, pa ndonjë diskriminim politik, fetar, racor dhe gjinor. Shoqëria ofron një edukim akademik të një niveli të lartë, si një përgjigje ndaj kërkeses së studentëve dhe përgatitjen për një karrierë të suksesshme.

Më 31 dhjetor 2018, Shoqëria ka pasur 709 punonjës (2017: 674).

2. Baza e përgatitjes

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare bashkangjitur janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të).

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

2.4 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, e cila supozon se Shoqëria do të vazhdojë aktivitetin e saj operacional në të ardhmen e parashikueshme. Në bazë të planit të miratuar financiar të Shoqërisë në vitet e ardhshme, Shoqëria parashikon të rrisë aktivitetin e saj operacional dhe gjithashtu është parashikuar një rezultat pozitiv në vitin e ardhshëm. Përveç sa më sipër, aksionarët e Shoqërisë janë të angazhuar për të mbështetur financiarisht Shoqërinë në rast se do të jetë e nevojshme.

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacioni në lidhje me fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet përkatëse në pasqyrat financiare. Përdorimi i vlerësimit kontabël është minimal në pasqyrat financiare aktuale duke marrë parasysh thjeshtësinë e natyrës së operacioneve që Shoqëria kryen.

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka çmime tregu të dukshme, kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit si më poshtë:

- Niveli 1: Çmimet e tregut të kuotuar (të parregulluara) në treg aktiv për instrumenta identike;
- Niveli 2: Teknika vlerësimi të bazuara në të dhënat të vëzhgueshme, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë (për shembull çmimi) ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë (për shembull të përfuara nga çmimi). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: çmimet e kuotuar në tregje aktive për instrumenta të njëjtë; çmimet e kuotuar për instrumenta identik ose të njëjtë në treg që konsiderohen më pak aktive; ose teknika vlerësimi ku të gjithë të dhënat hyrëse janë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi duke përdorur të dhëna të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku metoda e vlerësimit përfshin të dhëna hyrëse të cilat nuk janë të bazuara në të dhëna hyrëse të vëzhgueshme dhe ato kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta të cilat janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumenta të njëjtë ku rregullime të pavëzhguara të rëndësishme ose supozime janë të detyruara që të reflektojnë diferencat midis instrumentave.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontuara të flukseve monetare, krahasime me instrumenta të njëjtë për të cilat ekzistojnë çmime të vëzhgueshme në treg dhe të bazuara në kurbën e kthimit aktual të përshtatshme për pjesën e mbetur të maturitetit.

Supozimet dhe të dhënat hyrëse në metodat e vlerësimit përfshijnë norma interesi pa risk, hendekun e kredisë dhe prime të tjera të përdorura në llogaritjen normave të skontuara, obligacionet dhe çmimi i kapitalit neto, kurset e këmbimit, çmimi i kapitalit neto dhe çmimi i indeksuar i kapitalit neto dhe luhatjet korrelacionet e pritshme. Objektivi i teknikave të vlerësimit është që të arrijë në përcaktimin e vlerës së drejtë, e cila reflekton çmimet e instrumentave financiarë në datën e raportimit, që mund të ishte përcaktuar nga pjesëmarrësit në treg që veprojnë në mënyrë të vullnetshme.

Shoqëria përdor modele vlerësimi të njohura për përcaktimin e vlerës së drejtë për instrumenta financiare të zakonshme dhe të thjeshta si normat e interesit dhe monedha të shkëmbyeshme swap, të cilat përdorin të dhëna tregu të vëzhgueshme dhe kërkojnë pak gjykim dhe vlerësim nga drejtimi.

Çmimet e vëzhgueshme dhe të dhënat hyrëse në modele janë zakonisht të disponueshme në tregjet për borxhet dhe letrat me vlerë të kapitalit të listuar, shkëmbim derivativësh të tregtueshme dhe derivativë të thjeshtë si p.sh. normat e interesit swap. Disponimi i çmimeve të vëzhgueshme në treg dhe të dhënave hyrëse në modele ul nevojën për vlerësimin dhe gjykimin e drejtimit dhe gjithashtu ul pasigurinë që lidhet me përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponimi i çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe të dhënave hyrëse në modele ndryshon në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është i prirur që të ndryshojë në bazë të ngjarjeve specifike dhe kushteve të përgjithshme të tregjeve financiare.

Më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 të gjitha instrumentet financiare maten me koston e amortizuar.

2.6 Krahasueshmëria

Disa vlera krahasuese në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar dhe pasqyrës së veçantë të të ardhurave gjithëpërfshirëse janë riklasifikuar si rezultat i një ndryshimi në klasifikim për të pasqyruar një efekt më të mirë.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël**3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit janë njohur në fitim dhe humbje.

Zërat jo monetarë nuk janë ri-konvertuar në fund të vitit dhe janë matur në bazë të kostos historike (konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit), përveç zërave jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë të cilët konvertohen me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e raportimit janë si vijon:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
LEK / EUR	123.42	132.95
LEK / USD	107.82	111.10

3.2 Aktive afatgjata materiale**(i) Njohja dhe matja**

Zëri i aktiveve afatgjata materiale është e matur me kosto historike duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Kosto historike përfshin shpenzimet e lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Shpenzimet shtesë do të kapitalizohen në qoftë se nga përdorimi i tyre do të lindin përfitime ekonomike në të ardhmen dhe nëse shumat e tyre mund të matet me besueshmëri. Të gjitha kostot e tjera të mirëmbajtjes dhe riparimit njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në kohën kur ato ndodhin.

Fitimi ose humbja që vjen nga pakësimi i një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohet duke krahasuar shumën e arkëtuar nga pakësimi me vlerën kontabël të zërit, dhe njihet në baza neto në të ardhurat/shpenzimet e tjera operative në fitim ose humbje.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur duke shpërndarë koston e aktiveve afatgjata materiale përgjatë jetës së tyre të dobishme. Zhvlerësimi fillon kur aktivi është në dispozicion për përdorim. Normat e amortizimit janë si më poshtë:

Kategoritë e aktiveve	Metoda	Përqindja / vit
Ndërtesa	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje pune	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	20%
Makina	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	20%
Pajisje kompjuterike	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	25%
Të tjera	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	20%

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.2 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

(iii) Zhvlerësimi (vazhdim)

Jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi. Vlera kontabël neto do të ulet deri në vlerën e rikuperueshme nëse ajo tejkalon vlerën e mbetur të aktivit. Fitimi ose humbja neto që rrjedh nga shitja e një aktivi afatgjatë material njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

3.3 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jo materiale të blera nga Shoqëria të cilat kanë një jetë të dobishme të përcaktuar, janë të praqitura me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kosto shtesë

Kostot shtesë do të kapitalizohen në qoftë se nga përdorimi i tyre do të lindin përfitime ekonomike në të ardhmen. Të gjitha kostot e tjera, përfshirë shpenzime për emrin e mirë dhe markave të prodhuara do të njihen në pasqyrën e të ardhurave, kur ato ndodhin. Shpenzimet lidhur me mirëmbajtjen e softëare-ve kompjuterike njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet duke përdorur amortizimin linear mbi jetën e dobishme të aktivitet jo material që nga data e vënies në përdorim. Kostot e software-ve të njohura si aktiv do të amortizohen mbi vlerësimin e jetës së dobishme, e cila nuk është më shumë se 4 vjet. Jeta e dobishme rishikohet dhe rregullohet nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi. Fitimet dhe humjet që rrjedhin nga çregjistrimi i një aktivi jo-material maten si diferencë midis të ardhurës neto nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël neto të aktivitet dhe njihen si fitime ose humbje.

Për të vlerësuar humbjen, Shoqëria përcakton grupin më të vogël të aktiveve të cilat gjenerojnë flukse të identifikueshme të mjeteve monetare (njësia gjeneruese e mjeteve monetare). Si rezultat, disa aktive vlerësohen për humbjen individualisht dhe disa të tjera përfshihen në njësinë gjeneruese të mjeteve monetare.

3.4 Zhvlerësimi

(i) Aktive financiare jo derivative

Politika e zbatueshme nga 1 janar 2018

Instrumentet financiare

Shoqëria njih humbje nga zhvlerësimi për HPK-te mbi aktivitet financiare të matur me koston e amortizuar. Shoqëria e mat humbjet nga zhvlerësimi në një shumë të barabartë me HPK-të 12 mujore, sepse rreziku kreditor nga mosarkëtimi që pritet të ndodhi gjatë jetës së instrumentit financiar nuk është rritur në mënyrë të konsiderueshme nga njohja fillestare.

Në përcaktimin nëse rreziku kreditor të një aktivi financiar është rritur në mënyrë të konsiderueshme nga njohja fillestare apo kur behet matja e HPK-ve, Shoqëria merr parasysh informacion të arsyeshëm dhe të bazuar që është i përshtatshëm dhe është i arritshëm pa kosto apo punë shtesë. Kjo përfshin së bashku informacionin sasior dhe cilësor dhe një analizim, bazuar në përvojën e mëparshme të Shoqërisë e informimin mbi vlerësimin e kreditimit, dhe përfshirjen e informacionit për periudhat e ardhshme.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.4 Zhvlerësimi (vazhdim)

(i) Aktive financiare jo derivative (vazhdim)

Shoqëria supozon që rreziku kreditor për një aktiv financiar është rritur konsiderueshëm nëse arkëtimi i tij është me vonesë. Megjithatë, humbja mund të regjistrohet përpara se aktivi/të arkëtueshmet të jenë në vonesë nëse kjo mbështetet nga një informacion i arsyeshëm.

Shoqëria merr parasysh edhe faktorët mëposhtëm, për të vlerësuar nëse rreziku kreditor të një aktivi financiar është rritur konsiderueshëm:

- ndryshimet në shpërndarjen e kreditimit;
- ndryshimet aktuale ose të pritshme të normës së kredisë; ose
- kushtet që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme aktivitetin e biznesit, flukset monetare të pritshme dhe fitimet nga klientët.

Shoqëria konsideron një aktiv financiar të mos shlyhet në kohë kur klienti ka pak mundësi të paguajë detyrimin e tij të plotë ndaj Shoqërisë, pa ndërmarrjen nga Shoqëria të veprimeve si marrja e garancisë (nëse është mbajtur ndonjë).

HPK-te 12 mujore janë pjesa e HPK-ve që rezultojnë nga ngjarjet e mundshme të mospagimit brenda 12 muajve pas datës së raportimit (ose për një periudhë më të shkurtër nëse jeta e pritshme e instrumentit është më pak se 12 muaj).

HPK-te përgjatë jetës janë HPK-te që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të mospagimit përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Periudha maksimale e marrë parasysh në vlerësimin e HPK-ve, është periudha maksimale kontraktuale gjatë së cilës Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor.

Matja e HPK-ve

Humbjet e pritshme të kredisë janë një vlerësim i ponderuar i probabilitetit të humbjeve të kredisë. Humbjet e kredisë janë vlera aktuale e të gjithë mungesave monetare (si diferenca mes flukseve monetare për t'ju paguar entitetit sipas kontratës dhe flukseve monetare që Shoqëria pret të arkëtojë). HPK-te janë skontuar me normën efektive të interesit të aktivitetit financiar.

Aktive financiare me kredit të zhvlerësuar

Në çdo date raportimi, Shoqëria vlerëson nëse aktivet financiare të matura me koston e amortizuar janë me kredit të zhvlerësuar. Një aktiv financiar është me 'kredit të zhvlerësuar' kur ka ndodhur një ose disa ngjarje që kanë një ndikim negativ në flukset monetare të ardhshme të përlllogaritura.

Prova që një aktiv financiar është me kredit të zhvlerësuar, përfshin të dhëna të dallueshme si më poshtë:

- vështirësi e konsiderueshme financiare e klientit;
- një shkelje e kontratës si rasti i një mospagimi;
- është e mundshme që klienti të falimentojë ose të përfshihet në riorganizime të tjera financiare; ose
- ndryshime rregulluese që do kenë një ndikim negativ në flukset monetare të debitorit.

Prezantimi i zhvlerësimit për HPK-të në pasqyrën e pozicionit financiar

Humbjet nga zhvlerësimi për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar zbriten nga vlera e kontabël bruto e aktiveve.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.4 Zhvlerësimi (vazhdim)

(i) Aktive financiare jo derivative (vazhdim)

Pakësimi i vlerës

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar çregjistrohet kur Shoqëria nuk ka një pritshmëri të arsyeshme të rimarrjes së aktivitetit financiar si të plotë ose për një pjesë të tij. Shoqëria kryen një vlerësim mbi momentin dhe shumën e pakësimit duke u bazuar nëse ka një pritshmëri të arsyeshme të rimarrjes së tij.

Politika të zbatueshme përpara 1 janar 2018

Një aktiv financiar jo i mbartur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes është vlerësuar në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive për ta zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregojnë se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe ka pasur një ndikim negativ në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivitetit financiar dhe këto efekte maten në mënyrë të besueshme.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuara është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël (neto) dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivitetit. Humbjet janë njohur në të ardhura dhe shpenzime dhe janë reflektuar në një llogari zbritje nga llogaritë e arkëtueshme. Interesi mbi një aktiv të zhvlerësuar vazhdon të njihet nëpërmjet uljes së skontimit. Kur një ngjarje e ardhshme (pagesa nga një debitor) shkakton një rënie në shumën e humbjes nga zhvlerësimi, rënia e humbjes nga zhvlerësimi rimerret në pasqyrën e fitimit apo humbjes.

(ii) Aktivitet jo-financiare

Në çdo datë raportimi, Shoqëria rishikon vlerat kontabël (neto) të aktiveve të saj jo-financiare për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Për testimin e zhvlerësimit, aktivitet grupohen në grupe të vogla aktivesh të cilat gjenerojnë flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vazhdueshëm të cilat janë të pavarura nga flukset hyrëse monetare të aktiveve të tjera apo njësisë gjeneruese të parasë.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi apo njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Vlera në përdorim bazohet në vlerësimin e flukseve të ardhshme monetare të skontuara në vlerën e tyre aktuale, duke përdorur një normë skontimi para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike për aktivin ose njësinë gjeneruese të parasë.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera kontabël e aktivitetit apo njësisë gjeneruese të parasë është më e lartë se vlera e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në fitim ose humbje.

Humbjet nga zhvlerësimi rimerren vetëm në masën sa vlera kontabël e aktivitetit nuk e tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, nëse nuk do të ishte njohur humbja nga zhvlerësimi.

3.5 Inventari

Inventari matet me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përcaktohet bazuar në metodën e koston mesatare dhe përfshin koston e blerjes, koston e shndërrimit dhe gjithë koston e tjera për të sjellë inventarët në vendodhjen dhe në kushtet aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes përgjatë aktivitetit normal të Shoqërisë, minus koston e vlerësuara të përfundimit e shitjes.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.6 Instrumentet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht në datën e krijimit. Të gjithë aktivet e tjerë financiarë dhe detyrimet e tjera financiare janë njohur fillimisht në datën në të cilën Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv financiar (përveçse kur është një llogari e arkëtueshme pa një komponent të rëndësishëm financues) ose një detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejte shtuar, për një zë jo te matur me Vlerën e Drejtë Nëpërmjet Fitimit apo Humbjes (VDNFH), kostot e transaksionit që lidhen direkt me blerjen apo lëshimin e tij. Një llogari e arkëtueshme pa një komponent të rëndësishëm financues matet fillimisht me çmimin e transaksionit.

(ii) Klasifikimi dhe matja vijuese

Aktivitet financiare – Politika e zbatueshme nga 1 janar 2018

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur me: koston e amortizuar; VDATGJ – investimet në instrumentet e borxhit; VDATGJ – instrumente të kapitalit; ose VDNFH.

Aktivitet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare përveçse kur Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare, e në këtë rast të gjithë aktivitet financiare të prekura, riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit të modelit të biznesit.

Aktivitet financiare – Vlerësimi i modelit të biznesit: Politika e zbatueshme nga 1 janar 2018

Shoqëria kryen një vlerësim të objektivit të modelit të biznesit sipas të cilit mbahet një aktiv financiar. Informacioni i marrë parasysht përfshin:

- politikat dhe objektivat e specifikuar dhe zbatimi i këtyre politikave në praktikë. Këto përfshijnë nëse strategjia e drejtimit fokusohet në fitimin e të ardhurave të kontraktuara nga interesi, ruajtjen e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e çdo detyrimi të lidhur me to ose me daljen e pritshme të flukseve monetare ose realizimin e flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modelit të biznesit (dhe të aktiveve financiare të mbajtura brenda këtij modeli biznesi) dhe se si administrohen këto rreziqe.

Aktivitet financiare – Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit: Politika e zbatueshme nga 1 janar 2018

Për qëllimet e këtij vlerësimi, si ‘principal’ do të përkufizohet vlera e drejtë e aktivitet financiar në njohjen fillestare. ‘Interesi’ do të përkufizohet si e ardhura për vlerën në kohë të pasardhë dhe me rrezikun e kreditimit lidhur me shumën e mbetur të principalit gjatë një periudhe të caktuar kohe dhe për çdo kosto apo rrezik tjetër bazik mbi huadhënien (si rreziku i likuiditetit dhe kostove administrative), si dhe një marzh fitimi.

Në vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa principali dhe interesi, Shoqëria merr në konsideratë kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse aktivi financiar ka një kusht kontraktual që mund të ndryshojë kohëzgjatjen ose shumën e flukseve monetare kontraktuale në mënyrë të tillë që ky kusht nuk do të plotësohet.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.6 Instrumentet financiarë (vazhdim)

(ii) Klasifikimi dhe matja vijuese (vazhdim)

Në kryerjen e këtij vlerësimi, Shoqëria merr parasysh:

- ngjarje të kushtëzuara që mund të ndryshojnë shumën ose kohën e flukseve monetare;
- kushtet që mund të përshtatin normën kupon të kontraktuar, duke përfshirë opsione me normë të ndryshueshme;
- parapagimet dhe opsione zgjatje; dhe
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Shoqërisë për flukset monetare nga aktive specifike (si p.sh. karakteristikat “pa rekurs”).

Një karakteristikë parapagimi është në përputhje me kushtin e pagesave të kryera vetëm për principal dhe interes nëse shuma e parapaguar, në thelb përfaqëson shumën të papaguar të principalit dhe interesit mbi shumën e mbetur të principalit, e cila mund të përfshijë dhe një kompensim të arsyeshëm shtesë për ndërprerje para kohe të kontratës.

Aktivet financiare – Matja në vazhdim dhe fitimi dhe humbjet; Politika e zbatueshme nga 1 janar 2018

Aktivet financiare matur me koston e amortizuar

Këto aktive janë matur në vijim sipas koston së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kosto e amortizuar është zvogëluar nga humbjet nga zhvlerësimi. Të ardhurat nga interesi, fitimi apo humbja nga kurset e këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo fitim ose humbje nga çregjistrimi i aktivitetit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivet financiare – Politika të zbatueshme përpara 1 janar 2018

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare jo derivative si llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera të arkëtueshme dhe detyrimet financiare jo derivative si llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera detyrime financiare.

Aktivet financiare jo derivative dhe detyrimet financiare, njohja dhe çregjistrimi – Politika e zbatueshme përpara 1 janar 2018

Shoqëria fillimisht, i njeh të arkëtueshmet në datën kur ato krijohen.

Shoqëria e çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktiviteti shuhet, ose kur ajo transferon të drejtat për të marre këto flukse monetare, nëpërmjet një transaksioni në të cilin kalohen të gjithë rreziqet dhe përfitimet të pronësisë mbi aktivin financiar, ose kur ajo as nuk transferon as nuk mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk ka kontroll mbi aktivin e transferuar. Çdo interes në lidhje me çregjistrimin e aktivitetit financiar që është krijuar ose marrë nga Shoqëria njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale janë shkarkuar ose anuluar, ose skadojnë.

Aktivet financiare dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm atëherë kur Shoqëria ka aktualisht një të drejtë ligjore për të kompensuar vlerat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto ose të arkëtojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.6 Instrumentet financiarë (vazhdim)

(ii) Klasifikimi dhe matja vijuese (vazhdim)

Aktive financiare jo derivative, matja – Politika e zbatueshme përpara 1 janar 2018

Llogarite e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejte minus kostot e transaksionit që lidhet direkt me to. Në vijim të njohjes fillestare, ato maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Detyrimet financiare jo derivative, Matja – Politika e zbatueshme përpara 1 janar 2018

Detyrimet e tjera financiare jo derivative fillimisht maten me vlerën e drejtë zbritur çdo kosto transaksioni që lidhet direkt me to. Në vijim të njohjes fillestare, këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(iii) Çregjistrimi

Aktivet financiare

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar skadojnë, ose në qoftë se ajo transferon të drejtat për të arkëtuar flukset monetare kontraktuale të aktivitetit financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivitetit financiar transferohen ose në të cilin Shoqëria as nuk transferon as nuk mban të gjithë rreziqet dhe përfitimet dhe as nuk ka kontroll mbi aktivin financiar.

Shoqëria futet në një transaksion kur ajo transferon aktivet të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjithë ose pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar. Në këto raste, aktivet e transferuar nuk çregjistrohen.

Detyrimet financiare

Shoqëria e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shlyhen, anulohen ose skadojnë. Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij modifikohen, dhe flukset monetare të detyrimit të modifikuar janë rrënjësisht të ndryshme, dhe në këtë rast njihet me vlerën e drejte, një detyrim i ri financiar bazuar mbi kushtet e ndryshuara.

Ne çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës së mbetur dhe pagesës së kryer (duke përfshirë çdo aktiv jo monetar të transferuar apo detyrimi të marra përsipër) njihet në fitim apo humbje.

(iv) Kompensimi

Aktivet financiare dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm atëherë, kur Shoqëria ka aktualisht një të drejte ligjore për të kompensuar vlerat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto ose të përfitojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

3.7 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale. Aksionet klasifikohen si kapital.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.8 Njohja e të ardhurave

Shoqëria ka zbatuar për herë të parë SNRF 15 nga 1 janar 2018.

Njohja e të ardhurave sipas SNRF 15 (e zbatueshme nga 1 janar 2018)

E ardhura nga shërbimi lidhet me shitjen e shërbimit të shkollimit dhe transportit me një çmim të caktuar. E ardhura nga shitja e mallit lidhet me shitjen e uniformave dhe librave me një çmim të caktuar. Detyrimi është që të shpërndahet një seri mallrash dhe shërbimesh të dallueshme dhe çmimi i transaksionit është shuma që Shoqëria pret të ketë si të drejtë në këmbim për këto mallra ose shërbime. Detyrimi për shitjen e shërbimit realizohet përgjatë kohës, kështu që e ardhura njihet për çdo njësi të shitur me çmimin e transaksionit. Detyrimi për shitjen e mallrave realizohet në kohë, kështu që e ardhura njihet për çdo njësi të shitur me çmimin e transaksionit.

Shoqëria njih të ardhurat kur plotëson (ose në masën që plotëson) kushtin e performancës duke transferuar shërbimin e premtuar (shkollimin) tek klienti. Shkollimi konsiderohet i transferuar nëse (ose në masën që) klienti kontrollon atë aktiv.

3.9 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Qeveria Shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

3.10 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat nga huatë e dhëna, të ardhura nga efekti i kursit të këmbimit nga detyrimet ndaj huaja bankare. E ardhura nga interesi njihet kur ai përfitohet, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huamarrjet.

Kostot e huasë që nuk lidhen direkt me blerjen, ndërtimin apo prodhimin e një aktivi që kualifikohet për kapitalizimin e këtyre kostove, njihen direkt në rezultat duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit prezantohen neto si e ardhur ose shpenzim financiar në varësi nëse lëvizjet në kursin e këmbimit janë në një ekspozim neto fitimi apo humbje.

3.11 Tatimi mbi fitimin i periudhës dhe i shtyrë

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe ai i shtyrë njihen në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin apo humbjen e tatueshme të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është njohur për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Tatimi i shtyrë është matur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.11 Tatimi mbi fitimin i periudhës dhe i shtyrë (vazhdim)

Aktivitetet dhe pasivitetet tatimore të shtyra netohen nëse ekziston një e drejtë ligjore për të netuar detyrimet për tatimin aktual të pagueshëm ndaj tatimit të parapaguar, dhe ato lidhen me tatimin mbi të ardhurat që përcakton i njëjti autoritet tatimor.

Një aktivitet tatimor i shtyrë njihet për humbjet fiskale të papërdorura, kreditime tatimore dhe diferenca të përkohshme të zbritshme për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato të mund të përdoren. Aktiviteti tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë. Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e një pozicioni tatimor të paqartë dhe tatimet dhe interesat shtesë që mund të lindin. Shoqëria beson se përllogaritja e detyrimeve tatimore është e saktë për të gjitha periudhat e tatueshme bazuar në vlerësimin e disa faktorëve, duke përfshirë interpretimin e legjislacionit tatimor dhe ekperiencën e mëparshme. Kjo përllogaritje mbështetet në vlerësime dhe supozime si dhe mund të përshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Në rast se si rrjedhje e disponimit të një informacioni, gjykimi i Shoqërisë për mjaftueshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese ndryshon, ky ndryshim do të reflektohet në shpenzimin tatimor të periudhës kur ai përcaktohet.

3.12 Provigjonet

Provigjonet njihen kur si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime (ligjore ose konstruktive) të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Nëse efekti është material, provigjonet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të rrjedhës së mjeteve monetare të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimeve. Provigjonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më mundësi që një rrjedhje burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, të jetë e nevojshme për mbylljen e detyrimit, provigjonet rimerren. Provigjonet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht. Nuk njihet provigjon për humbjet e ardhshme operative.

3.13 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare të veçanta. Për një detyrim të kushtëzuar jepet informacion shpjegues vetëm kur mundësia e një daljeje burimesh që përfshin përfitime ekonomike nuk ekziston më. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare të veçanta por jepet informacion shpjegues kur realizimi i të ardhurave është i mundur. Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundur që ngjarje të ardhshme ta konfirmojnë atë, një detyrim që ka lindur deri më datën e raportimit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i humbjes.

3.14 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarët dhe drejtimi i Shoqërisë, së bashku me entitetet që kontrollojnë, të cilët kanë një ndikim të rëndësishëm mbi aktivitetin dhe drejtimin e Shoqërisë. Në marrjen në konsideratë të çdo marrëdhënie të mundshme me palët e lidhura, vëmendja i drejtohet thelbit të marrëdhënies, jo vetëm formës ligjore.

3.15 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin financiar të Shoqërisë në datën e raportimit (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së raportimit që nuk janë ngjarje rregulluese janë paraqitur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të veçanta nëse janë material.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.16 Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

3.16.1 Standardet dhe Interpretime efektive në periudhën aktuale

Ndryshimet në standardet ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, dhe interpretimet e miratuara nga Komiteti Ndërkombëtarë i Interpretimeve të Raportimeve Financiare, janë efektive për periudhën aktuale:

- **SNRF 9 “Instrumentat Financiare” dhe ndryshimet pasuese** (efektiv për periudhën vjetore më ose pas 1 janar 2018)

SNRF 9 "Instrumentat financiarë", publikuar më 24 korrik 2014 është zëvendësimi nga BSNK i SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja. SNRF 9 përcakton kërkesat për njohjen dhe matjen e aktiveve financiare, detyrimeve financiare dhe disa kontratave për blerjen apo shitjen e zërave jo-financiarë. SNRF 9 përfshin kërkesat për njohjen dhe matjen, zhvlerësimin, çregjistrimin dhe kontabilitetin e përgjithshëm. *Klasifikimi dhe matja* - SNRF 9 paraqet një qasje të re për klasifikimin e aktiveve financiare, e cila është drejtuar nga karakteristikat pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare dhe të modelit të biznesit sipas të cilit mbahet një aktiv. Kjo qasje e bazuar në parime, zëvendëson kërkesat ekzistuese të bazuara në rregullat sipas SNK 39. Modeli i ri rezulton gjithashtu në një model të vetëm zhvlerësimi që aplikohet në të gjitha instrumentet financiare. Kërkesat e reja të klasifikimit nuk kane një ndikim material mbi klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare.

Zhvlerësimi - SNRF 9 zëvendëson modelin e “humbjeve të ndodhura” të SNK 39 me modelin e “humbjeve të pritshme të kredisë” (HPK). Modeli i ri i zhvlerësimit do të aplikohet tek aktivet financiare të matura me koston e amortizuar, aktivet nga kontratat dhe instrumentet e borxhit me Vlerën e Drejte nëpërmjet të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse (VDATGJ), por jo për investimet në instrumente kapitali. Sipas SNRF 9, humbjet nga mos arkëtimi njihen me herët se sipas SNK 39. Për aktivet subjekt i modelit të zhvlerësimit sipas SNRF 9, humbjet nga zhvlerësimi përgjithësisht priten që të rriten dhe të bëhen më të luhatshme. Sipas SNRF 9, Shoqëria duhet të bëjë një vlerësim të HPK-se 12 mujore dhe HPK-ve përgjatë jetës. Shoqëria vlerësoi që zbatimi i SNRF 9 Instrumentet financiare nuk do ketë një ndikim material në zhvlerësimin e aktiveve financiare.

- **SNRF 15 “Të ardhurat nga kontratat me klientët”** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2018),

SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët" publikuar nga BSNK më 28 maj 2014 (më 11 shtator 2015 BSNK shtyu datën e hyrjes në fuqi të SNRF 15 deri më 1 janar 2018 dhe më 12 prill 2016 BSNK bëri sqarime për këtë standard). SNRF 15 specifikon se si dhe kur një raportues i SNRF-ve do të njohë të ardhurat, si dhe kërkon që subjekte të tilla t'u sigurojnë më tepër informacion përdoruesve të pasqyrave financiare të veçanta. Standardi zëvendëson SNK 18 "Të Ardhurat", SNK 11 "Kontratat e ndërtimit" si dhe një numër interpretimesh lidhur me të ardhurat. Zbatimi i standardit është i detyrueshëm për të gjithë raportuesit sipas SNRF-ve dhe zbatohet për pothuajse të gjitha kontratat me klientët: përjashtimet kryesore janë qiratë, instrumentet financiare dhe kontratat e sigurimit. Parimi bazë i standardit të ri është që shoqëritë të njohin të ardhurat për të përshkruar transferimin e mallrave ose shërbimeve te klientët në shumën që reflektojnë shpërblimin (pagesën), për të cilën shoqëria pret të ketë një të drejtë në këmbim të këtyre mallrave ose shërbimeve. Sipas SNRF 15, e ardhura njihet kur një klient merr kontrollin për mallrat apo shërbimet. Përcaktimi i momentit të transferimit të kontrollit – në një moment të caktuar apo përgjatë periudhës – kërkon gjykim. Për më shumë informacion mbi politikat kontabël të Shoqërisë në lidhje me njohjen e të ardhurave, shih shënimin shpjegues 3.8.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.16 Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

3.16.1 Standardet dhe Interpretime efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

- **Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat bazuar në Aksione"**, - Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve të pagesave me bazë aksionet (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2018),
- **Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e sigurimit"** - Aplikimi i SNRF 9 "Instrumentat financiarë" me SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, ose kur SNRF 9 "Instrumentat financiarë", është aplikuar për herë të parë),
- **Ndryshimet në SNK 40 "Aktivet Materiale Afatgjata të Investuara"** - Transferimet e aktiveve materiale afatgjata të investuara (efektive më ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28 si pasojë e "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 12, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 1 dhe SNK 28 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2018).
- **IFRIC 22 "Transaksionet në valutë dhe Konsiderata për Avancat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Zbatimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.16 Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

3.16.2 Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare të veçanta, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma nuk ishin në fuqi:

- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019).

SNRF 16 "Qiratë" publikuar nga BSNK më 13 janar 2016. Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qirasë. SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qera të zakonshme ose qera financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilizimeve nga qiramarrësit.

Kontratat e qirave të Shoqërisë lidhen me ndërtesat e marra me qira për zhvillimin e aktivitetit, dhe përmbushin kriteret për t'u identifikuar si qira, për të cilat qiramarrësi njih një aktiv me të drejtë përdorimi. Një vlerësim paraprak tregon që këto kontrata lidhen me qira të cilat janë të ndryshme nga qiratë afatshkurtra dhe ato me vlerë të ulët, për këtë arsye Shoqëria do të njohë një aktiv me të drejtë përdorimi dhe detyrimin përkatës të qirasë për të gjitha këto kontrata qiraje. Qiramarrësi do të kërkohet të njohë: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç rasteve kur aktivi është me vlerë të ulët; dhe (b) amortizimin e aktiveve të marra me qira veçmas nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

Shoqëria vendosi që do të zbatojë standardin nga data e tij e zbatimit të detyrueshëm, 1 janar 2019, duke përdorur metodën retrospektive dhe duke njohur efektin e akumuluar të zbatimit fillestar të këtij Standardi si një rregullim në tepriçën e fitimeve të pashpërndara (ose një përbërësi tjetër të kapitali neto, cili është më i përshtatshëm) në datën e zbatimit për herë të parë.

Në datën e fillimit të zbatimit të IFRS 16, qiramarrësi do të masë detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk janë paguar ende në atë datë, të cilat duhet të skontohe duke përdorur normën rritëse të huamarrjes të qiramarrësit. Në datën e fillimit të zbatimit të IFRS 16, qiramarrësi do të masë aktivin me të drejtë përdorimi me kosto, duke përfshirë shumën e matjes fillestare të detyrimin të qirasë, të rregulluar për shumën e ndonjë pagese qiraje të parapaguar ose të maturuar lidhur me atë qira të njohur në pasqyrën e pozicionit financiar para datës së zbatimit për herë të parë.

Shoqëria parashikon që aplikimi fillestar i SNRF 16, do të ketë një impakt material në pasqyrat financiare. Shoqëria ka vlerësuar detyrimin e qirasë në datën e aplikimit fillestar në shumën prej 566,711,780 Lek dhe aktivet me të drejtë përdorimi në shumën prej 625,953,380 Lek. Shoqëria është në fazën e implementimit të kriterëve të reja të kontabilitetit, megjithatë, ndikimet që nga 1 janari 2019 mund të jenë paksa të ndryshme për shkak të vlerësimeve të kërkuara dhe Shoqëria është në proces të testimit të sistemeve të reja të IT. Politikat e reja kontabël nuk do të jenë përfundimtare deri sa Shoqëria të paraqesë pasqyrat e para financiare pas datës së hyrjes në fuqi të SNRF 16.

- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit"** (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2021),
- **Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit"** - Përkufizimi i një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e aktiveve që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe).

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.16 Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

3.16.2 Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi (vazhdim)

- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentat Financiarë"** – Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo Kontributi i aseteve mes një Investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të jetë përfunduar),
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet"** - Përkufizimi i Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020),
- **Ndryshimet në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"** - Ndryshimi i planit, shkurtimi ose shlyerja (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019),
- **Ndryshimet në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015-2017)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe qartësimin e formulimit efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në Referencat në Kuadrin Konceptual në Standardet e SNRF** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020),
- **KIFRN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

Shoqëria ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja përpara datës kur hyjnë në fuqi. Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të veçanta të Shoqërisë në periudhën e zbatimit fillestar, përjashtuar SNRF 16.

TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë të shprehura në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***4. Aktive afatgjata materiale**

Aktivet afatgjata materiale për 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë të përbëra si më poshtë:

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Pajisje zyre	Pajisje kompjuterike	Në proces e pagesa pjesore	Totali
Kosto								
Teprica më 31 dhjetor 2017	359,784,577	2,297,516,415	58,174,839	23,295,600	424,695,158	153,071,138	-	3,316,537,727
Shtesa	-	-	348,115	-	3,324,787	1,809,250	177,328,239	122,810,391
Transferime	-	24,178,364	-	-	-	-	(24,178,364)	-
Teprica më 31 dhjetor 2018	359,784,577	2,321,694,779	58,522,954	23,295,600	428,019,945	154,880,388	93,149,875	3,439,348,118
Zhvlerësimi i akumuluar								
Teprica më 31 dhjetor 2017	-	(671,493,363)	(32,171,693)	(11,766,053)	(289,367,577)	(109,288,974)	-	(1,114,087,660)
Zhvlerësimi i vitit	-	(81,583,420)	(5,240,691)	(2,305,909)	(27,137,302)	(11,095,814)	-	(127,363,136)
Teprica më 31 dhjetor 2018	-	(753,076,783)	(37,412,384)	(14,071,962)	(316,504,879)	(120,384,788)	-	(1,241,450,796)
Vlera e mbetur neto								
Teprica më 31 dhjetor 2017	359,784,577	1,626,023,052	26,003,146	11,529,547	135,327,581	43,782,164	-	2,202,450,067
Teprica më 31 dhjetor 2018	359,784,577	1,568,617,996	21,110,570	9,223,638	111,515,066	34,495,600	93,149,875	2,197,897,322

Më 31 dhjetor 2018, tokat dhe ndërtesat e Universitetit Epoka dhe Kompleksit Turgut Ozal vazhdojnë të qëndrojnë të përdorura si kolateral për një hua afatgjatë marrë nga Intesa San Paolo Bank, National Bank of Greece (tashmë ABI Bank) dhe Raiffeisen Bank.

TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë të shprehura në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***5. Aktive afatgjata jomateriale**

Aktivet afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë të përbëra si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Aktive të tjera jomateriale	Totali
Kosto			
Teprica më 31 dhjetor 2017	406,940	11,741,850	12,148,790
Shtesa	305,500	-	305,500
Teprica më 31 dhjetor 2018	712,440	11,741,850	12,454,290
Zhvlerësimi i akumuluar			
Teprica më 31 dhjetor 2017	(38,911)	(11,741,850)	(11,780,761)
Zhvlerësimi i vitit	(142,924)	-	(142,924)
Teprica më 31 dhjetor 2018	(181,835)	(11,741,850)	(11,923,685)
Vlera e mbetur neto			
Teprica më 31 dhjetor 2017	368,029	-	368,029
Teprica më 31 dhjetor 2018	530,606	-	530,606

6. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhet nga:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Inventari	45,313,534	32,826,807
Zhvlerësimi i inventarit	(27,610,586)	(13,805,294)
Totali	17,702,948	19,021,513

Lëvizjet për zhvlerësimin e inventarit janë paraqitur si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Teprica hapëse	(13,805,294)	(13,405,028)
Zhvlerësimi i inventarit	(13,805,292)	(400,266)
Teprica mbyllëse	(27,610,586)	(13,805,294)

TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë të shprehura në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***7. Llogaritë e arkëtueshme tregtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Llogari të arkëtueshme tregtare	96,730,668	45,943,389
Totali	96,730,668	45,943,389

8. Aktive të tjera

Aktive të tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Parapagime	71,275,676	68,035,915
Tvsh e arkëtueshme	2,260,832	-
Shpenzime të shtyra	2,308,076	116,058
Totali	75,844,584	68,151,973

Parapagimet më 31 dhjetor 2018 përbëhen kryesisht nga parapagime të kryera sipas kushteve të kontratës për objektet e marra me qira si pagesë për vitin e fundit të qiradhënies.

9. Huatë

Huatë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Hua ndaj palëve të treta	12,347,430	32,196,775
Hua ndaj palëve të lidhura	18,513,000	-
Interes i arkëtueshëm	129,317	145,167
Totali	30,989,747	32,341,942

Hua ndaj palëve të treta i referohet kontratave të huase afatshkurtër, me një normë interesi të pandryshueshme prej 2% e pagueshme në maturim.

10. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Paraja në arkë		
Lek	3,111,368	20,740
Paraja në bankë		
Euro	5,757,186	20,917,800
Lek	3,509,185	3,797,904
USD	3,113,662	7,177,376
Totali	15,491,401	31,913,820

TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumatat janë të shprehura në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

11. Kapitali aksionar

Tabela më poshtë tregon strukturën e kapitalit të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 :

Aksionarët	Vlera e aksioneve 2018	Aksione në %	Vlera e aksioneve 2017	Aksione në %
BF Cooperatief U.A	1,133,700,000	100 %	1,133,700,000	100 %
Totali	1,133,700,000	100%	1,133,700,000	100%

BF Cooperatief U.A. operon si aksionar i vetëm i Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018. Kapitali i nënshkruar dhe i paguar përbëhet nga 1,133,700 aksione me vlerë nominale prej 1,000 Lek më 31 dhjetor 2018, (2017 : 1,133,700 aksione me vlerë nominale prej 1,000 Lek).

12. Huatë

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Hua nga Banka Intesa SanPaolo	491,245,400	616,478,515
Hua nga Banka Amerikane e Investimeve	7,965,691	23,290,358
Totali	499,211,091	639,768,873

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Hua nga Banka Intesa SanPaolo	131,439,772	128,294,027
Hua nga Banka Amerikane e Investimeve	13,655,189	14,709,588
Overdraft nga Banka Raiffeisen	96,439,434	78,590,436
Interes i pagueshëm	1,697,963	2,009,055
Totali	243,232,333	223,603,106

Më 14 prill 2015, Shoqëria ka lidhur një kontratë huaje me Bankën Kombëtare të Greqisë ("BKG") me qëllim kapital punues në vlerë 500,000 EUR (ekuivalentë në 70,145,000 LEK duke përdorur kursin e këmbimit 140,29 LEK/EUR) me kohëzgjatje prej 1 viti dhe normë interesi Euribor 12 mujor + 3% (minimum 4%). Huaja është siguruar me marrëveshjen e pengut "toka, ndërtesa, makineri e pajisje" për dy pasyri të paluajtshme: "Arë" me sipërfaqe 7,300 m² në Bërxull, Tiranë dhe "Arë" me sipërfaqe 1,700 m² në Bërxull, Tiranë. Më 26 korrik 2016, është nënshkruar rinovimi i kontratës së huasë me BKG dhe shuma e mbetur për t'u paguar prej 443,000 EUR (ekuivalentë në 60,372,040 LEK duke përdorur kursin e këmbimit 136.28 LEK/EUR) do të shlyhet brenda një periudhë 4 vjeçare me normë interesi Euribor 12 mujor (konfirmuar çdo tremujor nga Reuters) + 3% (minimum 5%).

Më 29 qershor 2015, Shoqëria ka lidhur një kontratë huaje me Bankën Intesa SanPaolo ("ISP") me qëllim investimi në vlerë EUR 1,000,000 (ekuivalentë në 140,310,000 LEK duke përdorur kursin e këmbimit 140,31 LEK/EUR) me kohëzgjatje prej 7 vitesh dhe normë interesi Euribor 1 vjeçar + 3,5% (minimum 4,5%).

Më 5 shkurt 2016, Shoqëria ka nënshkruar rinovimin e kontratës me ISP në lidhje me kontratën e nënshkruar më 10 gusht 2006 duke rritur vlerën e mbetur për t'u paguar me 500,000 EUR (ekuivalente në 69,145,000 LEK duke përdorur kursin e këmbimit 138,29 LEK/EUR) me kohëzgjatje prej 5 vitesh dhe interes Euribor 1 vjeçar + 3,5% (minimum 4,5%) për qëllim investimi.

Më 31 tetor 2016, Shoqëria ka lidhur një kontratë huaje me ISP në shumën 5,000,000 EUR (ekuivalentë në 682,350,000 LEK duke përdorur kursin e këmbimit 136.47LEK/EUR) me kohëzgjatjen prej 8 vitesh dhe normë interesi Euribor 1 vjeçar + 3.5% (minimum 4.5%). Huaja është siguruar me marrëveshjen e pengut "toka, ndërtesa, makineri e pajisje" për dy pasyri të paluajtshme: Kompleksi arsimor i ndodhur në zonën kadastrale 8240 dhe Universiteti Epoka në zonën kadastrale 1669 Tiranë.

TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë të shprehura në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***12. Huatë (vazhdim)**

Më 23 janar 2018, Shoqëria ka nënshkruar rinovimin e kontratës me ISP të datës 31 tetor 2016 duke rritur vlerën e mbetur për t'u paguar me 500,000 EUR (ekuivalente në 66,775,000 LEK duke përdorur kursin e këmbimit 133,55 LEK/EUR) me kohëzgjatje prej 3 vitesh dhe normë interesi Euribor 1 vjeçar + 3,5% (minimum 4.5%).

Më 21 qershor 2017, Shoqëria ka lidhur një kontratë overdrafti me Bankën Raiffeisen ("RZB") me qëllim likuiditeti për shpenzime operative në shumën 750,000 EUR (ekuivalentë në 99,487,500 LEK duke përdorur kursin e këmbimit 132,65 LEK/EUR) me kohëzgjatje 12 muaj dhe normë interesi Euribor 1 vjeçar + 4.5% (minimum 5.5%), i cili është rinovuar edhe për vitin 2018.

Më 05 korrik 2018, Shoqëria ka lidhur një kontratë overdrafti me RZB me qëllim kapital punues në shumën 250,000 EUR (ekuivalentë në 31,472,500 LEK duke përdorur kursin e këmbimit 125,89 LEK/EUR) me kohëzgjatje 10 mujore dhe normë interesi Euribor 1 vjeçar + 6 % (minimum 6%).

13. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Të pagueshme ndaj palëve të treta	49,591,397	40,316,745
Totali	49,591,397	40,316,745

14. Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Të pagueshme ndaj personelit	5,653,988	14,676,808
Kontribute shoqërore dhe shëndetësore	10,101,742	8,795,399
Tatimi mbi të ardhurat personale	4,893,240	5,010,911
Tatim në burim	248,460	697,728
Tatime të tjera të pagueshme	203,434	214,268
TVSH e pagueshme	-	2,608,232
Provizion për çështje gjyqësore	4,313,323	2,701,706
Detyrime të tjera	5,757,741	680,850
Totali	31,171,928	35,385,902

15. Detyrime ndaj palëve të lidhura

Detyrimet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Dividend i pagueshëm	114,687,833	3,336,313
Totali	114,687,833	3,336,313

Detyrimet ndaj ortakëve përbëhen nga dividendët për t'ju shpërndarë aksionarëve të Shoqërisë. Vlera e dividendit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 është përcaktuar sipas vendimit nr. 7 datë 27 korrik 2018.

TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë të shprehura në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***16. Të ardhura të shtyra**

Të ardhura të shtyra më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Të ardhura të shtyra	429,710,498	54,339,219
Totali	429,710,498	54,339,219

Të ardhurat e shtyra kanë të bëjnë me rregullimet e bëra ndaj të ardhurave nga shërbimet e njohura nga Shoqëria për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018. Të ardhurat e shtyra përfaqësojnë shumën e detyrimeve të paamortizuara për shërbimin e ofruar për klientët. Të ardhurat e shtyra do të amortizohen deri në fund të vitit shkollor 2018-2019.

17. Të ardhura nga shërbimet

Të ardhurat nga shërbimet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga tarifat e shkollimit	1,312,896,566	1,492,931,114
Zbritje nga tarifat e shkollimit	(125,692,148)	-
Totali	1,187,204,418	1,492,931,114

Të ardhurat nga arsimi përbëhen nga detyrimi sipas shërbimit të dhënë klientëve për vitin përkatës shkollor. Të ardhurat nga arsimi për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 përbëhen nga detyrimet që i përkasin pjesërisht vitit shkollor 2017-2018 dhe 2018-2019.

Rënia në të ardhurat nga shërbimet lidhet me njohjen e të ardhurave për vitin shkollor 2018-2019 në përputhje me transferimin e kontrollit të shërbimit tek klientët.

18. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Te ardhura nga shitja e librave	67,819,054	61,704,314
Të ardhura nga transporti	40,049,982	81,539,352
Të ardhura nga shitja e uniformave	39,675,734	35,059,526
Të ardhura nga shërbime të tjera	37,517,295	17,460,270
Të ardhura nga akomodim	11,521,464	7,657,438
Të ardhura të tjera	5,346,198	912,000
Totali	201,929,727	204,332,900

TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë të shprehura në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***19. Shpenzime personeli**

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga paga dhe kontributet të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime page	616,401,243	565,518,011
Shpenzime për kontributet shoqërore dhe shëndetësore	80,248,951	73,958,619
Shpenzime të tjera personeli	241,150	169,000
Totali	696,891,344	639,645,630

20. Lëndë e parë dhe mallra konsumi

Lëndë e parë dhe mallra konsumi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime për produkte ushqimore	178,535,304	180,342,518
Shpenzime për blerje librash	56,355,380	44,343,727
Shpenzime utilitare	41,456,245	38,462,527
Shpenzime për blerje uniformash	18,138,198	14,438,832
Shpenzime kancelarike	11,052,118	12,894,142
Totali	305,537,245	290,481,746

21. Shpenzime karburanti dhe transporti

Shpenzime karburanti dhe transporti për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime karburanti	24,366,345	22,957,466
Shpenzime transporti	77,941,134	75,425,175
Totali	102,307,479	98,382,641

22. Shpenzime qiraje

Shpenzime qiraje për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime qiraje	78,890,284	88,924,436
Totali	78,890,284	88,924,436

TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë të shprehura në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***23. Shpenzime shitjeje dhe marketingu**

Shpenzime shitje dhe marketingu për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime poste dhe komunikimi	3,063,621	3,103,715
Shpenzime reklame	2,489,145	1,977,116
Shpenzime përfaqësimi	2,163,769	1,842,507
Dhurata ndaj palëve të treta	-	318,138
Totali	7,716,535	7,241,476

24. Kosto financiare

Kostot financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime interesi	38,616,418	43,851,153
Shërbime bankare	2,620,242	1,068,862
Totali	41,236,660	44,920,015

25. Fitimi nga përkthimi i monedhave të huaja

Fitimi nga përkthimi i monedhave të huaja për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Humbja nga përkthimi i monedhave të huaja	(16,909,621)	(2,688,026)
Fitimi nga përkthimi i monedhave të huaja	63,031,087	14,280,181
Totali	46,121,466	11,592,155

26. Shpenzime të tjera operative

Shpenzime të tjera operative për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Dieta dhe shpenzime të tjera udhëtimi	31,907,003	23,547,584
Shpenzime për taksa	23,416,637	30,461,481
Shpenzime mirëmbajtje	21,918,030	16,923,629
Shpenzime trajnimi dhe provimesh	18,967,264	15,075,211
Shpenzime sanitare	14,485,765	12,431,285
Zhvlerësimi i inventarit	13,805,292	400,266
Shpenzime konsulence	7,512,113	4,297,318
Shpenzime anëtarësimi	1,946,576	1,179,121
Provigjon për çështje gjyqësore	1,611,617	2,701,706
Shpenzime sigurimi	965,852	769,302
Shpenzime të tjera	16,368,743	31,433,844
Totali	152,904,892	139,220,747

TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë të shprehura në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***26. Shpenzime të tjera operative (vazhdim)**

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 përbëhen nga subvencione për fondacionin Gulistan në shumën prej 10,151,412 Lek, nga humbja për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata fikse në shumën 4,466,070 Lek.

27. Shpenzim i tatim fitimit

Në bazë të legjislacionit tatimor shqiptar, norma e aplikuar e tatim fitimit për 2018 është 15% (2017: 15%). Tatim fitimi i njohur në fitim humbje për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Humbja)/fitimi para tatimit	(102,108,822)	232,791,580
Shpenzime të pazbritshme :		
Gjoha dhe penalitete	759,950	736,248
Zhvlerësimi i inventarit	13,805,292	-
Provizion për çështje gjyqësore	1,611,617	-
Subvencione dhe sponsorizime	-	7,203,766
Totali i shpenzimeve të pazbritshme	16,176,859	7,940,014
(Humbja)/fitimi i tatueshem	(85,931,963)	240,731,594
Shpenzim tatim fitimi i vitit	-	36,109,739
Përqindja efektive e tatim mbi fitimin	-	15.51%

Lëvizjet e tatim fitimit të parapaguar paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Teprica hapëse	(14,027,385)	16,470,973
Shpenzim tatim fitimi i vitit	-	(36,109,739)
Parapagimet për tatim fitimin	46,902,559	5,611,381
Teprica mbyllëse	32,875,174	(14,027,385)

Kthimet tatimore paraqiten çdo vit, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimore mbeten të përkohshme derisa autoritetet tatimore të shqyrtojnë raportet dhe të dhënat e tatimpaguesit dhe të bejnë një vlerësim përfundimtar. Ligjet tatimore shqiptare dhe rregulloret janë subjekt i interpretimeve nga organet tatimore.

28. Palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura paraqesin një transferim të burimeve, shërbimeve apo detyrimeve ndërmjet palëve të lidhura, pavarësisht nëse është vënë një çmim. Një palë e lidhur është pala që e kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën kontrollin e përbashkët me njësinë ekonomike; ka një interes në njësinë ekonomike që i jep ndikim domethënës mbi njësinë; ose ka kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike; është një bashkëpunëtor i njësisë ekonomike; është një joint venture në të cilën njësinë ekonomike është një ndërmarrje; apo është anëtar i personelit drejtues kryesor të njësisë ekonomike ose prindit të tij (duke përfshirë edhe anëtarët e familjes së ngushtë të ndonjë prej personave të lartpërmendur).

Një përmbledhje e transaksioneve me palët e lidhura paraqitet më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Hua ndaj palëve të lidhura	18,642,317	-
Dividend të pagueshëm	(114,687,833)	(3,336,313)
Totali	(96,045,516)	(3,336,313)

TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumatat janë të shprehura në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

28. Palët e lidhura (vazhdim)

Kompesimi i drejtuesve kryesore

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Përfitimet afatshkurtra		
Shpenzimet për pagat	34,890,542	32,027,316
Totali	34,890,542	32,027,316

29. Administrimi i rrezikut financiar

(a) Faktorët e rrezikut financiar

Aktiviteti i Shoqërisë e ekspozon atë ndaj disa rreziqesh financiare, duke përfshirë rrezikun e kredisë, rrezikun nga kurset e këmbimit dhe rrezikun e normave të interesit. Administrimi i rrezikut të Shoqërisë përqendrohet në paparashikueshmërinë e tregut dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi performancën e biznesit të Shoqërisë.

(b) Rreziku i likuiditetit

Ekziston rreziku që mjetet monetare mund të mos jenë të disponueshme për të shlyer detyrimet në kohën e duhur me një kosto të arsyeshme. Shoqëria monitoron likuiditetin e saj periodikisht në mënyrë që të administrojë detyrimet e saj kur nevojitet.

Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, struktura e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë në bazë të pagesave të pa aktualizuara është paraqitur më poshtë:

31 dhjetor 2018	Deri në 3 muaj	3 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vite	Më e gjatë se 5 vite	Totali
Huatë	(45,170,324)	(224,433,885)	(549,008,986)	-	(818,613,195)
Llogari të pagueshme tregtare	(42,110,357)	-	(7,481,040)	-	(49,591,397)
Detyrime të tjera	(28,082,329)	-	(3,089,599)	-	(31,171,928)
Detyrime ndaj palëve të lidhura	-	(114,687,833)	-	-	(114,687,833)
Totali	(115,363,010)	(339,121,718)	(559,579,625)	-	(1,014,064,353)

31 dhjetor 2017	Deri në 3 muaj	3 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vite	Më e gjatë se 5 vite	Totali
Huatë	(46,349,374)	(210,059,576)	(638,764,064)	(77,896,102)	(973,069,116)
Llogari të pagueshme tregtare	(40,316,745)	-	-	-	(40,316,745)
Detyrime të tjera	-	(32,271,789)	(3,114,113)	-	(35,385,902)
Detyrime ndaj palëve të lidhura	-	(3,336,313)	-	-	(3,336,313)
Totali	(86,666,119)	(245,667,678)	(641,878,177)	(77,896,102)	(1,052,108,076)

(c) Rreziku kreditor

Ekziston një rrezik kreditor në momentin që palët nuk arrijnë të përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale lidhur me pagesat e llogarive të arkëtueshme dhe aktiveve të tjera.

Shoqëria vlerëson cilësinë e të arkëtueshmeve të cilat nuk janë as në vonesë as të zhvlerësuar. Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 vlera e mbetur e aktiveve financiare që përfaqëson maksimumin e ekspozimit të rrezikut kreditor është zero.

TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumatat janë të shprehura në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

29. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i kurseve të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen prej ekspozimit ndaj monedhave të huaja, kryesisht ndaj monedhës së Euros. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për t'u mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit. Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur një pozicion të përshtatshëm neto në çdo monedhë dhe në total si dhe të monitoroj operacionet me bazë ditore.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 ishte si më poshtë:

Më 31 dhjetor 2018	Vlera kontabël (neto)	EUR	USD	GBP	LEK
Llogari të arkëtueshme					
tregtare	96,730,668	92,105,665	-	-	4,625,003
Huatë	30,989,747	30,989,747	-	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	15,491,401	5,757,186	3,113,662	-	6,620,553
Totali i aktiveve financiare	143,211,816	128,852,598	3,113,662	-	11,245,556

Më 31 dhjetor 2018	Vlera kontabël (neto)	EUR	USD	GBP	LEK
Llogari të pagueshme tregtare	(49,591,397)	(12,971,559)	(59,840)	(181,838)	(36,378,160)
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(114,687,833)	-	-	-	(114,687,833)
Huatë	(742,443,424)	(742,443,424)	-	-	-
Totali i detyrimeve financiare	(906,722,654)	(755,414,983)	(59,840)	(181,838)	(151,065,993)
Pozicioni neto i kursit të këmbimit	(763,510,838)	(626,562,385)	3,053,822	(181,838)	(139,820,437)

Më 31 dhjetor 2017	Vlera kontabël (neto)	EUR	USD	GBP	LEK
Llogari të arkëtueshme					
tregtare	45,943,389	41,550,252	-	-	4,393,137
Huatë	32,341,942	13,300,850	-	-	19,041,092
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	31,913,820	20,917,800	7,177,376	-	3,818,644
Totali i aktiveve financiare	110,199,151	75,768,902	7,177,376	-	27,252,873

Më 31 dhjetor 2017	Vlera kontabël (neto)	EUR	USD	GBP	LEK
Llogari të pagueshme tregtare	(40,316,745)	(2,729,889)	-	(1,814,101)	(35,772,755)
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(3,336,313)	-	-	-	(3,336,313)
Huatë	(863,371,979)	(863,371,979)	-	-	-
Totali i detyrimeve financiare	(907,025,037)	(866,101,868)	-	(1,814,101)	(39,109,068)
Pozicioni neto i kursit të këmbimit	(796,825,886)	(790,332,966)	7,177,376	(1,814,101)	(11,856,195)

TURGUT ÖZAL EDUCATION SHA**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë të shprehura në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***29. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(d) Rreziku i kurseve të këmbimit (vazhdim)***Më poshtë janë kurset e këmbimit të aplikuara gjatë vitit:*

	Kursi i këmbimit mesatar		Kursi i këmbimit në datën raportuese	
	2018	2017	2018	2017
EUR	127.58	134.15	123.42	132.95
USD	108.01	119.10	107.82	111.10

Analiza e ndjeshmërisë së monedhave të huaja

Analiza e ndjeshmërisë e paraqitur më poshtë është përcaktuar duke u bazuar në ekspozimin ndaj monedhave të huaja në datën e raportimit dhe ndryshimi ndodh në fillim të vitit financiar dhe mbahet konstant gjatë gjithë periudhës së raportimit. Skenari i mëposhtëm përcakton efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit në fitimin neto, duke konsideruar variablat e tjerë te pandryshueshëm.

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
EUR vlerësohet me 10%	(62,656,238)	(79,033,297)
EUR zhvlerësohet me 10%	62,656,238	79,033,297
USD vlerësohet me 10%	305,382	717,738
USD zhvlerësohet me 10%	(305,382)	(717,738)

(e) Vlera e drejtë

Matjet e vlerës së drejtë analizohen nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë si më poshtë: niveli parë janë një matje me çmime të kuotuarra (të parregulluara) në tregje aktive për aktive ose detyrime të njëjta, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknika të vlerësimit me të gjitha inputet materiale të vëzhgueshme për aktivin ose pasivin në mënyrë të drejtpërdrejtë (që është, si çmimet) ose indirekt (domethënë, rrjedhin nga çmimet), dhe (iii) të nivelit të tre matjet janë vlerësimet jo të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme në treg (pra, jo të inputeve vëzhgueshme). Drejtimi aplikon gjykimin në kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë.

Vlerat e drejta të analizuarra nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë dhe vlerat kontabël të aktiveve jo të matura me vlerën e drejtë janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018			Totali
	Vlera e drejtë Niveli i 1	Vlera e drejtë Niveli i 2	Vlera e drejtë Niveli i 3	
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	15,491,401	-	-	15,491,401
Huatë	-	-	30,989,747	30,989,747
Llogari të arkëtueshme tregtare Huatë	-	-	96,730,668	96,730,668
Llogari të pagueshme tregtare	-	-	742,443,424	742,443,424
	-	-	49,591,397	49,591,397

29. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Vlera e drejtë (vazhdim)

	31 dhjetor 2017			Totali
	Vlera e drejtë Niveli i 1	Vlera e drejtë Niveli i 2	Vlera e drejtë Niveli i 3	
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	31,913,820	-	-	31,913,820
Huatë	-	-	32,341,942	32,341,942
Llogari të arkëtueshme tregtare	-	-	45,943,389	45,943,389
Huatë	-	-	863,371,979	863,371,979
Llogari të pagueshme tregtare	-	-	40,316,745	40,316,745

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Duke qënë se këto balanca kanë afat të shkurtër dhe janë me norma interesi të ndryshueshme, vlera e drejtë e tyre është pothuajse e barabartë me vlerën kontabël.

Llogari të arkëtueshme tregtare

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme tregtare është afërsisht sa vlera e tyre e drejtë për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër.

Llogari të pagueshme tregtare

Vlera e drejtë e llogarive të pagueshme tregtare është afërsisht sa vlera e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër.

Huatë

Vlera e drejtë e vlerësuar e huave është afërsisht sa vlera e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër dhe normës bazë të interesit, e cila përafrohet me normat e tregut.

30. Angazhime dhe garanci

Gjatë rrjedhës normale të biznesit, Shoqëria mund të jetë e përfshirë në pretendime ligjore ose veprime të palëve të treta. Në bazë të mendimit të manaxhimit të Shoqërisë, përfundimi final në lidhje me këto çështje nuk do të ketë një efekt mbi pozicionin financiar të Shoqërisë, ose nuk do të sjellë ndryshime në aktive.

31. Ngjarje pas datës së raportimit

Më 31 maj 2019, Shoqëria ka nënshkruar rinovimin e kontratës së overdraftit me Bankën Raiffeisen ("RZB") të datës 5 korrik 2018 me qëllim kapital punues në shumën 250,000 EUR (ekuivalentë në 30,407,500 LEK duke përdorur kursin e këmbimit 122.63 LEK/EUR) me kohëzgjatje deri në datën 5 maj 2020 dhe normë interesi Euribor 1 vjeçar + 6 % (minimum 6%).

Më 31 maj 2019, Shoqëria ka nënshkruar rinovimin e kontratës së overdraftit me RZB të datës 21 qershor 2017 me qëllim likuiditeti për shpenzime operacionale në shumën 750,000 EUR (ekuivalentë në 91,972,500 LEK duke përdorur kursin e këmbimit 122,63 LEK/EUR) me kohëzgjatje deri në datën 5 maj 2020 dhe normë interesi Euribor 1 vjeçar + 4.5% (minimum 5.5%).

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat kërkojnë rregullime apo shënime të tjera shpjeguese në këto pasqyra financiare.

Inventari i mjeteve te transportit ne pronesi - 2018

NR	Lloji i automjetetit	Marka	Tipi	Model	Nr Shasie	Kapaciteti	Targa	Ngjyra	Viti I Prodhimit
1	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	905 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S351051	22 vendesh	TR5601R	E verdhe	2008
2	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	906 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S348289	22 vendesh	TR5602R	E verdhe	2008
3	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	907 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S349838	22 vendesh	TR5603R	E verdhe	2008
4	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	908 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S349244	22 vendesh	TR5604R	E verdhe	2008
5	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	909 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S348604	22 vendesh	TR5605R	E verdhe	2008
6	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	910 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S349837	22 vendesh	TR5606R	E verdhe	2008
7	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	911 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S350917	22 vendesh	TR5607R	E verdhe	2008
8	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	912 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066571S352485	22 vendesh	TR5608R	E verdhe	2008
9	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	913 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S349245	22 vendesh	TR5609R	E verdhe	2008
10	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	914 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066571S352486	22 vendesh	TR5610R	E verdhe	2008
11	Autoveture	Mercedes Benz	211	E220CDI	WDB2110061A233588	4+1	AA079RR	Blu te erret	2003
12	Autoveture	Mercedes Benz	211	E280CDI	WDB2110201A907190	4+1	AA856BI	E zeze	2005

HARTUESI

Gezina Qat



DREJTORI

Mustafa Ustiner